



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.04.2022, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Petro Koçi – zëvendëskryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të datës 23 mars 2022.
2. Diskutimi dhe miratimi i kalendarit të punës së komisionit për periudhën 18 prill – 6 maj 2022.

Marrin pjesë:

Petro Koçi, Besion Ajazi, Teuta Ramaj, Ilir Topi, Lindita Buxheli, Blerina Gjylameti, Florenc Spaho, Dasantila Tahiraj, Enslemvera Zake, Meri Markiçi, Luçiano Boçi, Agron Gjekmarkaj, Ina Zhupa, Eralda Bano Tase, Andia Ulliri, Merita Bakiu, Kastriot Piroli.

Mungojnë:

Flutura Aça dhe Eduard Ndreca.

HAPET MBLEDHJA

Petro Koçi – Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Sot në rendin e ditës kemi miratimin e procesverbalit të datës 23 mars 2022, si dhe diskutimin dhe miratimin e projektkalendarit të punës së komisionit për periudhën 18 prill – 6 maj 2022.

A jeni dakord me rendin e ditës? Dakord!

Kush është dakord me procesverbalin e datës 23 mars 2022? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet procesverbali.

Kalendari i propozuar për punën e komisionit është:

Ditën e mërkurë, datë 20 prill 2022, në orën 11:30, do të jetë diskutimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e Bashkimit Europian “*Horizont Europa*”, programi kuadër për kërkimin dhe inovacionin”. Ne jemi komision përgjegjës. Ndërkohë, komisionet për dhënie mendimi janë: Komisioni për Integrimin Europian dhe Komisioni për Politikën e Jashtme. Relator caktohet zoti Besion Ajazi.

Ditën e martë, datë 26 prill 2022, në orën 11:30, do të jetë diskutimi i projektligjit “Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nënzoneve të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit.”. Ne jemi komision për dhënie mendimi. Relatore nga maxhoranca caktohet zonja Dasantila Tahiraj dhe nga opozita zonja Ina Zhupa.

Çështja tjetër, e cila ishte parashikuar në datën 27 prill, shtyhet në datën 4 maj, ora 11:30, kur do të zhvillohet seancë dëgjimore për diskutimin e raportit për veprimtarinë 1-vjeçare për vitin 2021 të Autoritetit të Medieve Audiovizive.

Ndërkohë, janë edhe dy çështje të tjera që i keni në kalendar, të cilat do të jenë në vijim.

A jeni dakord me kalendarin?

Ina Zhupa – A mundem?

Petro Koçi – Po, zonja Zhupa.

Ina Zhupa – Kam diçka për të thënë paraprakisht.

Atëherë, unë e kuptoj që ju e keni me shpejtësi, por ne nuk e kemi me shpejtësi. Për shkak të mbledhjes suaj të grupit e filluam mbledhjen me vonesë dhe ne ju mirëkuptuam, por tani nuk mund të na vendosni rregulla se sa duhet ta zgjatim mbledhjen e komisionit.

Pika e parë ka të bëjë me kalendarin.

Për sa i përket kalendarit, për mua është e papranueshme që diçka, për të cilën ne kemi rënë dakord, e kemi votuar këtu dhe e kemi vendosur në kalendar, jo vetëm që nuk bëhet, jo vetëm që nuk marrim asnjë njoftim nëse është shtyrë, nëse është anuluar apo cili është problemi, por nuk e gjejmë të reflektuar as në kalendarin 3-javor. Bëhet fjalë për rastin e seancës dëgjimore me ministren e Rinisë dhe Fëmijëve, zonjën Bora Muzhaqi. E kam kërkuar personalisht në datën 24 nëntor 2021 dhe ka qenë në kalendarin e dy javëve të kaluara, në datën 12, për t'u bërë seanca dëgjimore. Nuk kam marrë asnjë njoftim pse u shty, kur u shty, pse u anulua apo cilat janë arsyet. Prisja minimalisht ta gjeja në rendin e ditës së sotme të çështjet e kalendarit 3-javor. Edhe Mbretëreshën e Anglisë të kishim kërkuar nga nëntori deri në fund të prillit, do të kishte gjetur kohën dhe do të kishte ardhur në komision. Është e papranueshme që ju po bëni çdolloj marifeti që të mos e sillni Borën këtu, sepse keni frikë se Bora bën gafa, keni frikë se Bora nuk përgjigjet. Këtë nuk e zgjidhim dot ne. Bora duhet të vijë këtu si ministre e Rinisë dhe Fëmijëve, kjo është kompetencë e këtij komisioni, siç u miratua në kalendar, ku e ngritëm dorën të gjithë bashkë dhe e miratuam, ndërkohë që ju e zhdukni nga kalendar, ikën edhe 3 javë, do të ikin edhe 3 javë të tjera dhe Bora do të vijë nëntorin tjetër, bashkë me borën si fenomen natyror. Të mos bëhemi qesharakë, por t'u qëndrojmë standardeve të Rregullores dhe asaj që kemi kërkuar që në datën 24 nëntor dhe sot është data 19 prill.

Kjo është çështja ime e parë për të marrë vëmendjen tuaj dhe për të marrë një zgjidhje, që të mos më thoni thjesht që kam të drejtë, se unë e di që kam të drejtë, por dua të futet në kalendar dhe të vijë këtu zonja, të dëgjohet për çështje me interes për fëmijët dhe të rinjtë shqiptarë. Raporti i fundit i INSTAT-it nxjerr që të rinjtë nga mosha 20 deri në 24 vjeç janë mosha, ku po tkurret më shumë popullsia dhe gjatë vitit kemi 15 mijë të rinj më pak, prandaj duhet të vijë këtu edhe Bora, se e kemi një ministre për Rininë.

Çështja e dytë, të cilën unë dua ta rregulloj njëherë e mirë, ka të bëjë me ju që drejtoni seancën e këtij komisioni, për shkak të funksionit tuaj si nënkryetar dhe në mungesë të kryetares, zonjës Aça. Nuk dua që kjo të bëhet përsëri çështje debati kur kemi të ftuar, sepse u marrim kohën të ftuarve dhe e heqim edhe atë lloj vëmendjeje që është më e madhe dhe medietike, kur kemi të

ftuar, ndaj mendoj që këtë çështje ta zgjidhim njëherë e mirë tani që nuk kemi të ftuar dhe kur kemi çështje të kalendarit.

Kjo është Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë dhe ju duhet të më gjeni në këtë Rregullore, ku unë apo çdo deputet e ka të ndaluar të bëjë pyetje dhe të marrë përgjigje, siç e kërkon. Unë kam kërkuar në rastin e fundit me zotin Fuga, siç mund të zgjedhim që t'i bëjmë të gjitha pyetjet bashkë e t'i marrim të gjitha përgjigjet bashkë për hir të specifikave që mund të kërkojë herë pas here çdo deputet që mendon se është e nevojshme të bëja pyetje dhe të merrja përgjigje. Ma gjeni në cilën pikë të Rregullores keni tagër këtu që të vendosni që deputeti nuk mund të bëjë pyetje dhe të marrë përgjigje një pas një. Po e gjetët këtu, ma thoni.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk kam mbaruar.

E dyta...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk kam shkuar ende tek e treta.

E dyta, për aq kohë sa Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë nuk ma ndalon, do të thotë që ma lejon dhe, për aq kohë sa ju nuk gjeni një nen që ma ndalon mua të zgjedh se si do t'i bëj pyetjet, atëherë mua më lejohet. Ju mund ta komandoni anën andej, por nuk mund ta komandoni kurrë opozitën në këtë komision dhe as të vendosni rregulla që i shpikni vetë se ku e kë, këtë apo atë.

E treta, mund t'i shikoni zbardhjet e procesverbaleve që në këtë moment. Nuk ka rast që unë të mos kem folur në komision dhe në zbardhje të mos jetë shënuar “ndërhyrje pa mikrofon”, “ndërhyrje pa mikrofon”, “ndërhyrje pa mikrofon”. Është komplet mungesë etike nga ana juaj dhe nga kolegët andej, kryesisht zoti Ajazi e bën këtë gjë, që, ndërkohë që flet kolegu me mikrofon, bën ndërhyrje pa mikrofon gjithë kohës. Nga ana këtej nuk ka ndodhur kurrë. Mund t'i shikoni procesverbalet, mund t'jua vë në dispozicion dhe fjala ime gjatë gjithë kohës del e zbardhur me “ndërhyrje pa mikrofon”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ja, ai vazhdon përsëri të ndërhyjë pa mikrofon.

Kjo është mungesë etike dhe rregulli në komision për të cilën ju, zoti kryetar i kësaj seance dhe jo i komisionit, duhet të vendosni rregull. Këtu nuk jemi në pazar, nuk jemi në rrugë, gjithsecili tregon kulturën e tij normalisht, por komisioni ka rregulla dhe ju jeni atje për t'i

monitoruar rregullat. Në qoftë se edhe ne të anës këtej fillojmë të flasim, ndërkohë që flisni ju apo flasin edhe ata, atëherë kot sa jeni ju aty, kot sa mbani rregullin, sepse këtu mbledhja kthehet në pazar. Juve duhet t'ju kishte rënë në sy vetë që gjatë gjithë kohës, nëse shikoni edhe zbardhjen e procesverbaleve, është “ndërhyrje pa mikrofon” dhe kjo nuk është normale.

Këto tri çështje unë i kam kryesisht me ju. Çështja e parë është parimore, sepse lidhet me seancën dëgjimore me zonjën Muzhaqi dhe dy çështjet e tjera janë çështje procedurale, po aq të rëndësishme për mbarëvajtjen e këtij komisioni dhe për punimet e këtij komisioni.

Shumë faleminderit!

Petro Koçi – Shumë faleminderit.

Lindita Buxheli – A mund të bëj një ndërhyrje të vogël, nëse mundem?

Duke qenë se jam edhe pjesë e Komisionit të Çështjeve Sociale, ne e kemi kërkuar dhe ministrja e Rinisë dhe e Fëmijëve ka ardhur dhe është përgjigjur në mënyrë shumë dinjitoze. Ajo nuk ka nevojë fare që unë t'i bëj avokaten dhe çuditë si ju e keni kërkuar dhe nuk paska ardhur në Komisionin e Medies! Pra, ajo është paraqitur sa herë që ne e kemi kërkuar dhe...

Ina Zhupa – A e kemi kërkuar? A e kemi miratuar?

Petro Koçi – Zoti Boçi, e ka fjalën.

Mos ndërhyri, kur flasin të tjerët!

Luciano Boçi – Faleminderit!

Së pari, dua të mbështes shqetësimin e zonjës Zhupa për vonesën e ardhjes së ministres në seancë dëgjimore. Ministrja mund të jetë e gatshme të shkojë në çdo komision, mund të shkojë dhe në Hënë apo në Mars, por këtu i është bërë një thirrje, është deklaruar rendi i ditës dhe nuk ka shtyrje pafund, ndaj duhet të ishte paraqitur me kohë, sepse jo vetëm zonja Zhupa, por edhe unë dhe zoti Gjekmarkaj, kur drejtonte komisionin në fillimet e punimeve të këtij komisioni, kemi kërkuar seancë dëgjimore me ministren për Rininë dhe Fëmijët. Seanca është shtyrë dhe po shtyhet në kalendat greke. Nuk duhet të ketë justifikime dhe nuk po supozoj dyshime të tjera, por ne kërkojmë të zbatohet Rregullorja.

Gjithashtu, kam një vërejtje lidhur me mënyrën se si menaxhohen seancat dëgjimore në komision. Diskutimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e Bashkimit Europian “*Horizont Europa*”, programi kuadër për kërkimin dhe inovacionin” është një projekt i rëndësishëm, që vazhdon prej vitesh dhe

unë shikoj që të ftuar në seancë dëgjimore janë: zonja Albana Tole, zëvendësministre e Arsimit dhe Sportit, dhe zonja Mirela Muça. Kjo është pjesë e mbrojtjes dhe e parashtrimit të politikave dhe funksionin politik e ka ministri përkatës për Arsimin, ndaj unë pretendoj që në seancë dëgjimore të jetë i pranishëm ministri i Arsimit dhe jo niveli i zëvendësministres ose zëvendësministrit, sepse programi është shumë i rëndësishëm, aq më tepër që jemi në vitin e revolucionit digjital të shpallur në programin politik dhe buxhetor të ministres dhe duhet të vijë këtu ta mbrojë këtë lloj revolucion, i cili ka hyrë në muajin e tij të pestë apo të gjashtë dhe nuk po shikojmë asgjë të prekshme për këtë revolucion. Njëkohësisht, me paraqitjen e këtij programi dhe impakteve të tij, të na paraqesë edhe një lloj konkluzioni për efektshmërinë e këtij programi, sepse ka vite që vërtitet në seanca dhe duhet një parapërgatitje çfarë ka sjellë, çfarë ka bërë në raport me stafet, me studentët, ku është impakti shkencor dhe në çfarë lartësie janë ngritur universitetet tona nga shpenzimi i këtyre parave, të cilat nuk ka rëndësi nëse vijnë nga Europa apo vijnë nga Shqipëria. Prandaj, unë pretendoj që të ngrihet niveli i seancës dëgjimore dhe këtu të na vijë ministrja e Arsimit, e cila nuk ka pse të shmanget dhe, në qoftë se ka axhendë të ngarkuar, mund ta shtyjë diskutimin, pasi projektligji është shumë i rëndësishëm, nuk është ratifikim marrëveshjeje nga ato standardet, por është një marrëveshje shumë e rëndësishme për universitetin dhe arsimin e lartë. Këto kisha.

Faleminderit!

Petro Koçi – Faleminderit!

Lidhur me çështjen e fundit për të ftuar ministren, unë mendoj se mund të bisedojmë me ministren, por edhe pozicioni i zëvendësministrit është një pozicion politik dinjitoz, për të qenë pjesë e mbledhjeve të komisioneve parlamentare. Nuk është dëgjuesë, por është diskutim projektligji, pra do të ketë aspekte teknike, por sidoqoftë do ta bisedojmë me ministren, pasi do të ishte më mirë që të jetë edhe vetë ministrja në mbledhje.

Lidhur me zonjën Muzhaqi, unë mendoj se ndoshta në datën 4 maj mund ta organizojmë që të jetë prezente. Meqenëse do të jetë edhe një javë më e lirë, mendoj se mund të bëjmë një seancë më të gjatë...

Ina Zhupa – Mund të bëjmë një seancë 12 orë.

Petro Koçi – Në rregull, e lëmë në ato ditë, pastaj dhe mund ta lëmë për një ditë tjetër, por datën nuk e vendosim dot, sepse duhet një koordinim paraprak.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord, mund ta menaxhojmë dhe do ta komunikojmë në grupin e *whats app*-it për ta zgjidhur të gjithë së bashku këtë çështje.

Për sa i përket mënyrës se si shtrohen pyetjet, në Rregullore nuk specifikohet, por ka një precedent. Zakonisht është precedenti që vendos për gjërat që nuk qartësohen në Rregullore.

E dyta, deputetët zakonisht i konsumojnë pyetjet radhazi, por edhe kur lind diçka për më pas, sikurse ka qenë edhe rasti juaj, u jepet fjala sërish, gjithmonë duke respektuar radhën, për të mos e bërë mbledhjen me protagonizëm individual, që njëri pyet, tjetri përgjigjet gjatë të gjithë kohës dhe të tjerët të qëndrojnë si spektatorë, sepse nuk është e logjikshme. Ai ose ajo që bën pyetjet, parashtron të gjitha dhe më vonë i lind e drejta që, sipas logjikës së përgjigjeve, të përsërisë apo të bëjë pyetje të tjera. Mendoj se kjo është rruga më e mirë, por ne mund të konsultohemi. Mendoj se është në etikën e mbarëvajtjes së punës së komisionit, që personi t'i konsumojë të gjitha pyetjet, pavarësisht se ju kishit shumë pyetje dhe mund të duket si një proces i lodhshëm. Nuk besoj se kemi arsye të bëjmë debat.

Urdhëroni!

Ina Zhupa – Zoti Koçi, së pari, më pëlqen që keni ndryshuar qasje dhe tonalitet, ndryshe nga mbledhja e kaluar, kur thoshit: “Këtu vendos unë; është në Rregullore; mos u përgjigj, zoti Fuga, sepse e them unë” e të tjera. Keni kaluar në një qasje që mund të diskutohet, sepse herën e kaluar ju vepruat në një mënyrë që nuk e lejon Rregullorja. Pra, Rregullorja nuk ta jep atë kompetencë.

Çështja tjetër, sërish në lidhje me këtë, unë si deputete i kam bërë të gjitha pyetjet në seanca dëgjimore. Sikurse të gjithë, kam pritur përgjigjet dhe nuk e kam kërkuar ndonjëherë këtë gjë. Siç e lejon Rregullorja, në raste të caktuara, kur deputeti e çmon të arsyeshme, mund të vazhdojë me pyetje, sepse në rastin e atij institucioni, unë e thashë edhe argumentin, pasi është institucion i ri, përfaqësuesit vinin për herë të parë, por për sa i përket kompetencave, sikurse e tha zotëria: “Kemi ligj për të vendosur zëdhënësit, por nuk i kam vendosur, sepse kam lënë ata që ishin”, e të tjera, pra ai është i ri, dhe konsumohen pyetje të tilla, kur nuk dihet lloji i përgjigjes që do të jepet. Në rastin e këtij institucioni, pyetjet-përgjigjet ju lehtësojnë edhe juve, sepse mund të shmangni 3-4 pyetje që unë mund të bëj më vonë, që personi të japë përgjigje pse nuk ka ndodhur. Pra, ishte specifika e institucionit. Kur deputeti arsyeton kërkesën, se për çfarë arsyeje e kërkon këtë gjë, nuk ka të bëjë me marrjen e kohës apo protagonizmin, sepse marrja e kohës është kur i bëj të gjitha pyetjet, i shfaq më lehtë në rrjetet sociale, është video e pandërprerë, marr kohën time, por të vendosni ju për

diçka, që nuk keni tagër, mund të jetë bonsens, precedent, konsensus, quajeni si të doni, por nuk është në Rregullore.

Për aq kohë sa unë e rezervoj veten, dua që këtë diskutim ta mbyllim sot dhe të mos e hapim më. Do të vijë institucioni i AMA-s? Po, do t'ia bëjmë pyetjet të gjitha bashkë, është një institucion i konsoliduar.

Do të kemi rast tjetër, kur unë ose dikush do ta çmojë të nevojshme, që këto të bëhen për të shmangur problematikat, atëherë ju do të keni thjesht detyrimin të menaxhoni seancën për pyetje dhe përgjigje, jo të vendosni rregulla apo të urdhëroni njerëzit që vijnë, të flasin apo të mos flasin. Këto i thashë për të mos folur kur ka të ftuar, sepse harxhojmë kohën e komisionit dhe të të ftuarve, për ta mbyllur së bashku në paqe dhe pa e zgjatur.

E fundit, që ju nuk e përmendët, por do të ishte mirë të flisnit dhe t'u kërkonit të gjithë anëtarëve të komisionit, të opozitës dhe të maxhorancës, kryesisht të maxhorancës, që kur flet një anëtar i komisionit, të mos bëjnë rrugë ndërhyrje pa mikrofon, sepse nuk na shkon, aq më tepër që jemi Komisioni i Medies.

Faleminderit!

Petro Koçi – Unë nuk kam ndryshuar qasje, besoj se jam i njëjti në të gjitha mbledhjet, por të ftuarit i jepet fjala nga drejtuesi i seancës. Besoj se unë nuk kam diskriminuar asnjë nga radhët e kolegëve apo të ftuarve, por ka një rregull normal, në bazë të të cilit vijon një mbledhje.

Për sa i përket ndërhyrjes së kolegëve, kur ka qenë diçka e tepërt jam përpjekur të ndërhyj që të mos ndodhë, sepse kur flet dikush, është mirë që të tjerët ta dëgjojnë, brenda një niveli të pranueshëm, pasi ka edhe batuta pa dashakeqësi, që mund të tolerohen, por kur bëhen shqetësuese, nuk duhen toleruar, pasi pengohet vijimësia normale e mbledhjeve.

Për sa i përket renditjes së pyetjeve, parlamenti ka një komision që merret me Rregulloren dhe ata ndoshta mund të na bëjnë një interpretim, por unë mendoj se ky është precedenti. Zakonisht deputetët i rendisin të gjitha pyetjet, aq sa mund të quhen të gjitha, sepse më vonë mund të lindë një arsye për të shtuar pyetje të tjera, por përgjithësisht kështu ndodh, sidomos nga ana e opozitës, pasi janë më të motivuar. Mbledhja me zotin Fuga ishte kryesisht e motivuar nga ju, dhe unë, në respekt të saj, pasi nuk dua të shfrytëzoj pozitën time kur drejtoj seancën, as faktin që ka një maxhorancë, që nëse del, mbledhja ndërpritet, por ne duhet të vijojmë të respektojmë njëri-tjetrin në mënyrën më maksimale të mundshme.

E kuptoj që ndonjëherë pozitat politike ndoshta na i deformojnë sjelljet, por është mirë që drejtuesi të mundohet të mos ndodhë ky deformim dhe ne të kemi një marrëdhënie sa më normale të mundshme. Besoj se jam përpjekur ta luaj një rol të tillë moderuesi. Shpesh ju kam dhënë shumë të drejtë për thelbin e pyetjeve dhe interesit që keni treguar, pavarësisht se nuk jam dakord me retorikë.

Pa dashur të bëj replikë me zotin Boçi, kur foli për revolucion, këto gjëra ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord, nuk ka rëndësi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk ka nevojë të sqaroni asgjë.

Mund të kishit thënë se ky proektligj është shumë i rëndësishëm dhe unë si deputet kam mendimin të vijë vetë ministrja, është mirë të mos jetë vetëm zëvendësministrja prezente, pa e ngarkuar fjalorin, por është një çështje ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ne donim të bënim një mbledhje të shkurtër, por po stërgjatet.

Luçiano Boçi – Unë e falënderoj ...

Petro Koçi – Ngacmimi ishte shumë miqësor, nuk ishte ...

Luçiano Boçi – Dakord.

Unë e falënderoj zotin Koçi për sugjerimet se si mund ta ndërtoj unë fjalinë dhe ta mbush me figuracion, por fatkeqësisht, personalisht jap dy lëndë të lidhura me to, retorikën dhe teorinë e letërsisë.

Petro Koçi – Thashë ta zbrazësh nga figuracioni, jo ta mbushësh ...

Luçiano Boçi – Po, sugjerove si ta përdor, nuk thashë ta mbush. Ta mbush ose të mos e mbush, por pushka mbahet e mbushur, nuk mund të lihet bosh.

Revolucionin nuk e përmenda unë, por e përmendi zonja ministre, kur ka ardhur në seancë dëgjimore për të paraqitur programin e qeverisë dhe buxhetin, tekstualisht: “hyjmë në një vit të revolucionit digjital”. Kemi bërë debat për këtë gjë.

Dua që zonja të vijë ta sqarojë edhe një herë revolucionin digjital, e përsëris dhe me “rr” të fortë, sepse zonja Albana Tole ka vetëm 3 ditë e emëruar zëvendësministre e Arsimit dhe Sportit, por nënshkruese e marrëveshjes është zonja ministre. Nuk po kërkojmë luks, por të vijë dhe të na paraqesë ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kërkesa ime shumë e thjeshtë rrethohet nga retorika. Retorika bie. Çdo njeri ka stilin e vet, profilin e vet...

Petro Koçi – Për retorikën fola. Pavarësisht ngarkesës ...

Luçiano Boçi – Është me stile kjo, zoti Koçi.

Petro Koçi – Dakord, por jo me stil pushke.

Luçiano Boçi – Ai është stili, nuk kam çfarë t'i bëj stilit.

Petro Koçi – Fjalën e ka zonja Blerina.

Blerina Gjylameti – Unë e dëgjova me shumë vëmendje...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po ju ndiqja, edhe pse isha në takim tjetër.

Në këtë komision ne kemi diskutuar dhe debatuar rregullisht, madje kemi lënë edhe hapësirë shumë herë më të madhe për pjesën e opozitës sesa për anëtarët e maxhorancës, ndaj, të thuhet se shpesh herë ne nuk arrijmë të kemi ekuilibra, nuk arrijmë të gjithë listën e pyetjeve, apo të adresojmë problematikat, nuk është e vërtetë. Mendoj se keni pasur hapësirën tuaj.

Ndërkohë, për sa i përket ministres...

Më falni, edhe diçka. Ndërhyrjet pa mikrofon, ndoshta ndonjëherë nuk janë të duhura, por shpesh herë, duke qenë se, nuk dua të them “uzurponi”, por kapni pjesën më të madhe të kohës dhe nuk mbani radhë, që do të ishte mënyra më e mirë, një anë këtej dhe një anë andej, me një kohë të përcaktuar, sepse koha pa përcaktim do të thotë të lihen hapësira të mëdha në njërin palë dhe ngrihen pikëpyetje të mëdha për palën tjetër, sa kur t'i vijë radha, ka përfunduar mbledhja dhe nuk arrijmë të debatojmë, ndaj ne ndoshta do të duhet të vendosim një marrëveshje midis palëve, që secili të marrë 5-10 minuta, më pas të marrë fjalën dikush nga krahu tjetër...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, sepse mund të jenë 30 pyetje. Mund të ndahen, 3 pyetje nga njëra anë dhe 3 pyetje nga ana tjetër.

Nëse do të kemi, nëse nuk do të kemi, do të vijojmë. Por nëse do të kemi, duhet të jetë kështu. Ne e dimë shumë mirë që në çdo parlament të Europës ka kohë të përcaktuar për pyetjet dhe për përgjigjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Edhe në komisione kemi kohë të përcaktuar.

Megjithatë, meqenëse ne të dy, Luçiano, jemi pak më shumë në pjesën e mandateve, jo sa Petro, por gjithsesi, do të doja të thosha diçka: në rastin e ministres së Arsimit, aq shumë e kemi pasur ministren e Arsimit prezente në këto 7 muaj sa nuk kemi pasur ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, në afat, në kohë.

Nuk kemi pasur kaq shumë në 4 vjet ministër më parë. Besoj se ne hapësitat për të pasur ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, vetëm ministren, jo të tjerët.

Nëse do të shikojmë kohën e ministrave në komisione, besoj se ministria Kushi mban *polposition* në këto 6 muaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër që ka institucion të rëndësishëm.

Ndërkohë, besoj se nëse kemi çështje që duhen adresuar, nuk kemi pse ta bëjmë te marrëveshja. Marrëveshja është kuadër dhe ne e dimë. Madje, opozita ka kërkuar rregullisht të ndryshojmë procesin e miratimit të marrëveshjeve në parlament. Mendoj se nëse kemi pyetje që janë më gjerë sesa thjesht marrëveshja, që bëhet fjalë për procesin e digjitalizimit, ta thërrasim në dëgjësë, nuk kemi pse ta bëjmë vetëm për një marrëveshje. E përsëris, sikundër e kemi treguar, që e thërrasim rregullisht dhe sikundër na ka treguar, vjen gjithmonë me shumë dëshirë dhe u përgjigjet edhe pyetjeve që dalin komplet jashtë rendit të ditës, agjendës apo temës për të cilën e kemi thirrur.

Tjetra, kam edhe një sugjerim për të pasur një mirëkuptim dhe për të ndryshuar edhe pak mënyrën e të punuarit. Ndoshta parashtesa që bën gjithsecili, patjetër në varësi të aftësisë personale apo të të laburuarit të temës, dikush ka më shumë apo më pak kohë, por te parashtesa duhet ta shkurtojmë pak ...

Të vazhdojmë me pyetjet, të marrim përgjigjet dhe te komentet të marrim kohën tonë, sepse komentet janë pjesë e qëndrimit politik, ku çdo palë e bën me shumë dëshirë, vullnet, por edhe me argument. Kështu e mendoj.

Petro Koçi – Jemi jashtë rendit të ditës.

Unë gjej se ky komision ka funksionuar normalisht. Ne kemi bërë seanca dëgjimore shumë të gjata, që besoj se pas komisioneve hetimore ne jemi në nivelin më të lartë të seancave, por ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, e kam fjalën që e kemi kryer detyrën. Nuk besoj se kemi lënë gjëra mangët.

Nëse do të duhet të bëjmë sërish seanca dëgjimore, ne mund t'i bëjmë.

MBYLLET MBLEDHJA